

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 56 të statutit të Komunës së Deçanit, Kryetari i komunës së Deçanit, më dt. 11.03.2020, merr këtë:


V E N D I M

PER THEMELIMIN E SHTABIT EMERGJENT PËR PARANDALIMIN E COVID -19


- I. Themelohet grupi punues për parandalimin e virusit COVID - 19, Në nivel të Komunës së Deçanit, në këtë përbërje:
1. Izet Zenuni – Drejtoria për M.Sh dhe Sh.P Shef i Shtabit emergjent.
 2. Agron Demukaj – Drejtoria për Buxhet dhe Financave,
 3. Faik Jahmurataj – Komandanti i Policisë,
 4. Dafina Cacaj – Shefe e Kabinetit të Zyra e Kryetarit,
 5. Musë Berisha – Drejtor i Shëndetësisë dhe mirëqenies sociale,
 6. Halil Tolaj- Drejtor i Inspeksionit
 7. Dr. Xhavit Rabushaj – QKMF
 8. Bekim Vishaj – Drejtor i Arsimit
 9. Mërgim Panxhaj – Kompania Komunale Higjiene
- II. Shtabi emergjent ka për detyrë që të koordinoj punët në zyre dhe në teren të të gjitha ekipeve koordinuese për parandalimin e COVID -19, bën monitorimin, evidentimin e institucioneve publike dhe private të frekuentuara nga qytetaret duke vlerësuar rregullisht gjendjen e tyre. Shtabi emergjent bënë raportimin dhe njofton Kryetarin e Komunës në baza ditore për gjendjen aktuale në teren.
- III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana kryetarit.
- IV. Me vendim njoftohen
Të emëruarit në piken I. Të vendimit, dhe
Arhivi i Komunës së Deçanit,

02.Nr.

Dt.11.03.2020



Kryetari i Komunes
Bashkim Ramosaj



14.03.2020


Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 1.6, 1.8 dhe 1.9, vendimin e datës 13.03.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kryetari i komunës së Deçanit merr këtë:

V E N D I M

Të nderuar qytetarë të Deçanit, përfaqësues të subjekteve afariste që veprojnë në territorin e komunës së Deçanit, për shkak të rrethanave të krijuara nga "Corona virusi" (COVID -19) dhe me qëllim të tejkalimit të kësaj situatë na duhet të marrim një vendim e përbashkët nga sot:

1. Ndalohet ushtrimi i veprimtarive afariste përjashtuar ushqimoret, farmacitë, pompat e derivateve në tërë territorin e komunës së Deçanit. Njëkohësisht ju ftoj të gjithëve që ti respektoni vendimet e nxjerrura nga Qeveria e Republikës së Kosovës ku pezullohen të gjitha aktivitetet kulturore e sportive dhe kufizimi i lëvizjeve të pa nevojshme dhe reduktimi i këtyre lëvizjeve vetëm në situata të domosdoshme.
2. Kërkojmë nga farmacitë, marketet me artikuj ushqimorë e të ngjashme, të mos e shfrytëzojnë situatën me abuzim me çmime, në të kundërtën do të ushtrohen fletëparaqitje penale për abuzime.
3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe vlen deri në një vendim tjetër.
4. Ju faleminderit për mirëkuptimin së bashku do ta tejkalojmë situatën.

Kryetari i Komunës
Bashkim Ramosa





16.03.2020

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 1.6, 1.8 dhe 1.9, vendimin e dt.13.03.2020 dhe vendimin e dt.15.03.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kryetari i komunës së Deçanit merr këtë:

V E N D I M

Për shkak të rrethanave të krijuara nga "Corona virusi" (COVID -19) dhe me qëllim të tejkalimit të kësaj situate Kryetari i Komunës së Deçanit merr këtë vendim:

1. Ndalohej veprimtaria e të gjitha kompanive ndërtimore dhe depove të materialit ndërtimor që veprojnë në territorin e komunës së Deçanit, deri në një vendim tjetër.
2. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe vlen deri në një vendim tjetër.
3. Ju faleminderit për mirëkuptimin së bashku do ta tejkalojmë situatën.

Kryetari i Komunës
Bashkim Ramosaj





Bazuar ne urdhëresën e dt.20.03.202, Nr. Ref.01/04, Konfromë zbatimit të kësaj urdhërese Kryetari i Komunës së Deçanit nxjerr këtë:

V E N D I M

(Për Zbatimin e Kësaj Urdhërese Gjatë Emergjencës Së Shëndetit Publikë)

- I. Në bazë të këtij vendimi urdhërohen të gjithë operatorët ekonomik në komunën e Deçanit që ju dedikohet urdhëresa Nr. Ref. 01/04
- I. Në rast të mos zbatimit që ka të bëjë me urdhëresën në fjalë do të pasojnë masat ndëshkimore sipas Ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
- II. Urdhërohet inspektoriati i Komunës së Deçanit, Policia e Kosovës - Stacioni Policorë në Deçan që ta zbatojnë këtë vendim


Të bashkëngjitur me këtë vendim e keni edhe urdhëresën Nr. Ref. 01/04

- III. Me këtë vendim njoftohen:
Operatorët Ekonomik ne Komunën e Deçanit
Inspektoriati Komunal
Policia e Kosovës- Stacioni policore në Deçan.

Deçan, 21.03.2020

Kryetari i Komunës

Bashkim Ramosaj





Zyra e Kryetarit

02/ 2020

Dt. 23 / 03 / 2020

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 28/2008 datë: 04.06.2008, në pajtim me nenin 1.6, 1.8 dhe 1.9 të vendimit nr. 01/07 të datës 11.03.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe kërkeses Nr 02/8120 date 23.03.2020 nga DMSHSHP dhe Shtabi Emergjent i Komunes se Deçanit Kryetari i Komunës së Deçanit merr këtë:

V E N D I M

- I.** Me qëllim të parandalimit të Covid 19 të vendimit nr. 01/07 të datës 11.03.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin janë miratuar masat parandaluese, dhe Ligjeve ne fuqi ne raste emergjente Kryetari i komunes Aprovon kërkesen nr 02/8120 te dates 23.03.2020 per furnizime emergjente siq vijon :

Furnizim me pako ushqimore 310 familje (lista e skemes sociale)

Furnizime me material dezinfektues dhe deratizues per objektet publike komunale sipas nevojave dhe ne veqanti per nevoja standard te QKMF-se

Furnizim me rroba mbrojtese per stafin e QKMF-se , kompanise Higjiena, Zjarrfikesve dhe stafi komunal

Furnizim me dezinfektues per nevoja ditore per stafin e QKMF-se , kompanise Higjiena, Zjarrfikesve dhe stafi komunal

Furnizim me jelek me mbishkrim te posaqem per stafin e QKMF-se , kompanise Higjiena, Zjarrfikesve dhe stafi komunal

Furnizmi me bexha dhe karta special te levizjes per stafin e QKMF-se , kompanise Higjiena, Zjarrfikesve dhe stafi komunal

Furnizime me derivate per stafin e QKMF-se , kompanise Higjiena, Zjarrfikesve dhe stafi komunal

Furnizime tjera emergjente te cilat do te aprovohen nag Shtabi Emergjent Komunal dhe do te autorizohen nag Shefi I Shtabit

II. Te gjitha kompetencat mbi këto furnizime autorizohen tek shtabi emergjent komunal përkatësisht tek shefi i shtabit.

III. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria per Mbrojtje, Shpetim dhe Shërbime publike dhe drejtoria për Buxhet dhe financa të komunës së Deçanit.

Me vendim njoftohen:

1x1. Zyra e Kryetarit;

1x1. Drejtoria për M.SH.SH.P;

1x1. Drejtoria për buxhet dhe financa ;

1x1. Arkivi i komunës

Kryetari i komunës:
Bashkim Ramosaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI

Deçan
07.04.2020
Zyra e Kryetarit

Bazuar në Nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligji 03/L0-40, paragrafi 7 të Nenit 15 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

I

Me anë të këtij vendimi komuna e Deçanit, funksionalizon Eko -Tregun për shitjen e produkteve bujqësore të prodhuara nga fermerët e Deçanit.

II

Me këtë vendim njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Deçanit që nesër me datën 08.04.2020 duke filluar nga ora 09:00 do të filloj punën Eko-Tregu në Deçan, i cili gjendet në rrugën Elez Gezi e Magjun Berisha (te pazari).

Eko - Tregu do të jetë i përditshëm me orar nga ora 09:00 në mëngjes deri në ora 16:00 pas dite.

III

Të gjithë prodhuesit e produkteve bujqësore që i shesin produktet e tyre në Eko- Treg duhet të jenë të pajisur me mjete mbrojtëse (Maska dhe doreza)

IV

Bazuar në vendimet e nxjerrura nga Shtabi Komunal për menaxhimin e pandemisë COVID -19, ju njoftojmë se të gjithë qytetarët që duan të furnizohen me produkte nga Eko- Tregu duhet të jenë të pajisur me mjete mbrojtëse (maska dhe doreza).

Arsyetim: Me qëllimin e mire për t'ju dalur në ndihmë fermerëve dhe blegtorëve tonë si komunë e Deçanit kemi funksionalizuar Eko -Tregun.

Kryetari Komunës

z.Bashkim Ramosaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI

Zyra e Kryetarit
Nr. 02- Zyrtarisht
Dt. 13.04.2020

Ne bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 13 paragrafi 3 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04/L-125, nenit 4.1, 8.2 dhe 41.2 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse Nr. 02/L-109, Planit të Reagimit Kombëtar, mbi përgjegjësitë e Kryetarit të Komunës dhe nenit 56 pika 19 e Statutit të Komune së Deçanit, pas shqyrtimit të situatës lidhur me parandalimin e Pandemisë Covid -19, pas takimit me Shtabin Komunal për Menaxhimin e Emergjencës Shëndetësorë, Kryetari Komunës bie këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim ndalohet, në tërë territorin e komunës së Deçanit furnizimi sipas porosive On-Line (posta e shpejtë).
2. Ndalohet veprimtaria ndërtimore e të gjitha ekonomive familjare të cilat janë duke zbatuar kontrata ndërtimore me pune-kryes që janë jashtë komunës së Deçanit, të gjitha këto aktivitete janë të ndaluara deri në një njoftim të radhës.
3. Ndalohet veprimtaria ndërtimore operatoreve ekonomik që kanë kontrate me komunën e të cilët sjellin nën-kontraktorë nga qytetet tjera të Republikës së Kosovës, për të kryer punët në komunën e Deçanit sipas kontratës. Përveç në rrethana të domosdoshme sipas vlerësimit të Shtabit Komunal.
4. Ndalohet çdo shërbim nëpër makete, farmaci, furra, pompa të derivateve dhe operatoreve tjerë që janë të lejuar të punojnë në këtë kohe, nëse nuk i zbatojnë masat mbrojtëse e sidomos mbajtjen e distancës sociale.
5. Vendimi hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit të kryetarit të komunës dhe për zbatimin tij pakujdesen:

Policia e Kosovës – Stacioni Policore në Deçan
Inspektorati i Komunës.



Arsyetim: me qellim te tejkalimit te gjendjes se krijuar nga virusi Corona pa dashur qe ta stigmatizojmë askënd, komuna e Deçanit është e detyruar ta nxjerr këtë vendim si masë mbrojtëse.

Ne vazhdim gjate ditës do ju njoftojmë me rekomandimet e dalura sot nga takimi i Shtabit Komunal Emergjent.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Të gjithë qytetarët e Deçanit
2. Policia e Kosovës
3. Inspektorati Komunal
4. Arkiva e Komunës

Deçan 13 prill 2020

Kryetari i Komunës
Bashkim Ramosaj

